



Institute
for Democracy
and Mediation

NED NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

METODOLOGJI

Për monitorimin e konsultimit publik
në qeverisjen qendrore



**Autorë:**

Prof. Asoc. Dr. Nadia Rusi
Megi Reçi

Rishikimi:

Gjergji Vurmo

Redaktimi letrar dhe dizajni:

Durim Tabaku

© Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe National Endowment for Democracy,
2024.

Kjo metodologji është hartuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në kuadër të Projektit "Forcimi i transparencës dhe qeverisjes së mirë përmes konsultimit publik" mbështetur financiarisht nga National Endowment for Democracy (NED). Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e National Endowment for Democracy.

Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtimeve	3
1. Hyrje	4
2. Fokusi i vlerësimit	6
3. Kujt i drejtohet instrumenti metodologjik?	7
4. Procesi i hartimit të metodologjisë së konsultimit publik	8
Faza I: Shqyrtimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor mbi konsultimin publik.....	8
Faza II: Hartimi i metodologjisë	8
Faza III: Konsultimi i instrumentit metodologjik.....	9
Faza IV: Testimi i metodologjisë	10
5. Parimet e konsultimit publik	11
6. Procesi i përzgjedhjes së institucioneve dhe akteve objekt monitorimi	13
Kriteret për përzgjedhjen e institucioneve.....	13
Kriteret për përzgjedhjen e akteve	14
7. Mbledhja e të dhënave	16
8. Sistemi i pikëzimit të treguesve	17
9. Vlerësimi i performancës së institucioneve në realizimin e procesit të konsultimit publik	19
10. Shtojcat	21
Shtojca 1. Matrica e vlerësimit sipas treguesve	21
Shtojca 2. Literatura e rekomanduar	35
Shtojca 3. Dokumentet objekt vlerësimi, baza ligjore dhe lidhja me treguesit.....	37
Shtojca 4. Udhëzime për hartimin e kërkesave për informim.	43



Lista e shkurtimeve

- IDM Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
- KM Këshilli i Ministrave
- OSHC Organizata të Shoqërisë Civile
- PKIE Plani Kombëtar i Integritimit Evropian
- PPAP Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve
- RENJK Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik
- RIA Raporti i Ndikimit Rregullator
- SP Sekretari i Përgjithshëm
- VKM Vendim i Këshillit të Ministrave

1. Hyrje

Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrjen publike nënkupton pjesëmarrjen në diskutimet lidhur me ligjet dhe politikat publike që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme. Qeveritë përdorin forma të ndryshme për ta realizuar këtë, një prej të cilave është konsultimi publik.

Konsultimi publik gjithëpërfshirës ndihmon në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe legjitimitetit të vendimeve të qeverisë. Ai u bën të mundur qytetarëve të japin kontributin e tyre në formësimin e vendimmarrjes publike, duke promovuar në këtë mënyrë rritjen e bashkëpunimit mes qeverisë nga njëra anë dhe shoqërisë civile dhe qytetarëve nga ana tjetër. Në këtë kuptim, konsultimi publik është një mjet jetik në një shoqëri demokratike për të siguruar që vendimet e qeverisë trajtojnë dhe përputhen me nevojat dhe pritshmëritë e qytetarëve.

Nga ana tjetër, procesi i konsultimit publik është një instrument i rëndësishëm që mund të ndikojë në rritjen e shkallës së pranueshmërisë dhe zbatimit të vendimeve të qeverisë nga ana e qytetarëve.


Në këtë kuadër, ky instrument metodologjik ka si qëllim të shërbejë për monitorimin e procesit të konsultimit publik në qeverisjen qendrore. Baza kryesore ligjore ku është mbështetur është Ligji Nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik" dhe aktet nënligjore përkatëse. Instrumenti është hartuar për t'i shërbyer kryesisht organizatave të shoqërisë civile në nismat e tyre për monitorimin e procesit të konsultimit publik.

Përdorimi i këtij instrumenti monitorimi është i rëndësishëm për disa arsye:

Së pari, monitorimi i procesit të konsultimit publik bën të mundur që proceset e vendimmarrjes të jenë më transparente, duke shmangur kështu vendimmarrjen që anashkalon angazhimin dhe përfshirjen e qytetarëve.

Së dyti, monitorimi i procesit të konsultimit publik mund të ndikojë në rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje. Nëpërmjet monitorimit të procesit të konsultimit mund të identifikohen sfidat dhe të merren masa për siguruar një pjesëmarrje sa më gjithëpërfshirëse.

Së treti, monitorimi i procesit të konsultimit publik mund të ndihmojë në garantimin e cilësisë dhe integritetit të vendimmarrjes, duke siguruar që vendimet e qeverisë bazohen në të dhëna dhe nuk janë si rezultat i interesave të ngushta politike, apo në mbështetje të grupeve të caktuara që kanë ndikim në nivelet vendimmarrëse.



Së katërtri, monitorimit i procesit të konsultimit publik ndihmon në rritjen e llogaridhënies së institucioneve publike ndaj qytetarëve dhe u jep këtyre të fundit mundësinë për të kuptuar sa të përfaqësuar janë dhe sa dëgjohet zëri i tyre.

Për sa më sipër, monitorimi i procesit të konsultimit publik është i rëndësishëm për të siguruar një proces vendimmarrës të drejtë, gjithëpërfshirës dhe efektiv, duke ndihmuar në forcimin e demokracisë dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe vendimmarrjes së institucioneve publike.

Në mënyrë më specifike, metodologjia e monitorimit të procesit të konsultimit publik bazohet në kuadrin ligjor për njoftimin dhe konsultimin publik si më poshtë:

- Ligji Nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 828/2015, "Për miratimin e rregullave për krijimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të njoftimeve dhe konsultimeve publike";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 584, datë 28.8.2003, "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave";
- Urdhri i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, Nr. 3/2021, "Për miratimin e udhëzuesit për procesin e konsultimit publik".



2. Fokusi i vlerësimit

Ky instrument shërben për të monitoruar:

1. Nivelin e transparencës së qeverisë në lidhje me procesin e konsultimit publik;
2. Nivelin e llogaridhënies së qeverisë në hartimin dhe konsultimin e politikave publike dhe ligjeve;
3. Shkallën e aksesueshmërisë së dokumenteve të konsultimit publik;
4. Efektivitetin e konsultimit publik;
5. Nivelin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të qytetarëve në procesin e konsultimit publik;
6. Garantimin e gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit gjatë konsultimit publik.



3. Kujt i drejtohet instrumenti metodologjik?

Ky instrument metodologjik është hartuar për t'i shërbyer së pari organizatave të shoqërisë civile, fokus i veprimtarisë së të cilave është monitorimi i proceseve vendimmarrëse dhe veçanërisht monitorimi i procesit të konsultimit publik në qeverisjen qendrore.

Nga ana tjetër, instrumenti metodologjik është i vlefshëm për t'u mbajtur në konsideratë nga aktorët e qeverisjes dhe nga të gjitha institucionet në nivel qendror, me qëllim vetëvlerësimin e tyre në përputhje me parimet dhe treguesit e vlerësimit të konsultimit publik që janë pjesë e këtij instrumenti.

4. Procesi i hartimit të metodologjisë së konsultimit publik

Hartimi i instrumentit të monitorimit të procesit të konsultimit publik kaloi në disa faza:

Faza I: Shqyrtimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor mbi konsultimin publik

Gjatë kësaj faze të procesit, në fokus ishte shqyrtimi i bazës ligjore dhe rregullatore mbi të cilën do të ndërtohej instrumenti i monitorimit. Po ashtu, u identifikuan kërkesat ligjore dhe rekomandimet që duhet të përmbushen nga çdo institucion publik gjatë kryerjes së procesit të konsultimit publik për projektaktet që ata kanë planifikuar të hartojnë. Në mënyrë specifike, në këtë fazë u krye hartimi i listës së kriterëve që duhen ndjekur nga institucionet qendrore në kuadër të procesit të konsultimit publik. Disa prej këtyre kriterëve janë detyruese, pasi burojnë nga akte ligjore dhe nënligjore, ndërsa disa të tjera janë të rekomanduara pasi burojnë nga praktikat e mira ose udhëzuesi i konsultimit publik.

Faza II: Hartimi i metodologjisë së monitorimit të konsultimit publik

Me konsultimin e bazës ligjore dhe identifikimin e kriterëve, u kalua në fazën e dytë të procesit: hartimi i instrumentit metodologjik. Pas listimit të treguesve që do të shërbenin për vlerësimin e institucioneve dhe akteve objekt monitorimi, u bë organizimi i tyre sipas parimeve bazë të konsultimit publik: transparenca, aksesueshmëria, efektiviteti, llogaridhënia, gjithëpërfshirja, mosdiskriminimi dhe pjesëmarrja qytetare.

Gjithashtu, në këtë fazë të procesit u hartua edhe metodologjia e pikëzimit të treguesve. U vlerësua nga ekspertët që të gjithë treguesit të kenë të njëjtën peshë vlerësimi dhe të vlerësohen sipas një sistemi me 3 shkallë: 0, 1 dhe 2 pikë. Pra, për secilin tregues numri maksimal i pikëve të vlerësimit është 2. Për të lehtësuar punën e monitoruesit si edhe për të qenë objektiv gjatë procesit të monitorimit, u hartua gjithashtu edhe matrica udhëzuese lidhur me sistemin e pikëzimit në të cilën jepen shpjegime lidhur me shkallën e vlerësimit 0, 1 dhe 2 pikë.


Në lidhje me hartimin e sistemit të vlerësimit, vlen të theksohet që u bë edhe identifikimi dhe ndarja e atyre treguesve që do të mateshin vetëm një herë, në nivel institucioni (kryesisht procese ose dokumente që hartohen në nivel vjetor) dhe e treguesve që do të llogariteshin në nivel akti (pra, për çdo akt të konsultuar).

Në përfundim të vlerësimit, institucionet renditen sipas tre shkallëve të performancës në terma të performancës në realizimin e procesit të konsultimit publik: nivel i lartë, niveli i mesëm dhe niveli i ulët.

Së fundmi, në këtë fazë të procesit, u hartua lista e kriterëve për përzgjedhjen e institucioneve dhe akteve që do të jenë objekt monitorimi nga ky instrument. (Shih më poshtë, Kreu 6. Procesi i përzgjedhjes së institucioneve dhe akteve objekt monitorimi.)

Kjo fazë përfundon me hartimin e draftit të instrumenti të monitorimit të procesit të konsultimit publik sipas: **6** parimeve, **31** treguesve të performancës dhe **3** niveleve të performancës. Në mënyrë skematike, përmbajtja e metodologjisë së monitorimit jepet në figurën e mëposhtme.

Figura 1. Përmbajtja e metodologjisë së monitorimit



Faza III: Konsultimi i instrumentit metodologjik

Gjatë fazës së tretë, ekspertët u fokusuan në konsultimin e metodologjisë dhe kriterëve të përzgjedhjes së institucioneve dhe akteve objekt monitorimi me grupet e interesit. Konsultimi u realizua me organizata të shoqërisë civile si dhe përfaqësues të institucioneve të qeverisjes qendrore, ekspertë të SIGMA/OECD dhe përfaqësues të departamentit përgjegjës për monitorimin e procesit të konsultimit publik pranë Kryeministrisë. Në përfundim të procesit të konsultimit, u rishikuan disa aspekte të draft metodologjisë me qëllim reflektimin në versionin përfundimtar të komenteve dhe sugjerimeve të aktorëve të konsultuar.

Faza IV: Testimi i metodologjisë

Versioni përfundimtar i metodologjisë së monitorimit u testua nga ekipi i IDM-së gjatë periudhës shkurt-mars 2024, duke e zbatuar atë fillimisht për vlerësimin e dy institucioneve dhe dhjetë akteve të konsultuara prej këtyre të fundit. Kjo fazë shërbeu për të kryer disa saktësime të fundit në matricën udhëzuese dhe shpjegimet e ofruara prej saj lidhur me shkallën e vlerësimit 0, 1 dhe 2 pikë. Sugjerimet e nxjerra nga gjetjet e testimit u shqyrtuan nga ekspertët dhe u përfshinë në tekstin e metodologjisë, e cila u pilotua nga IDM gjatë periudhës mars-maj 2024 për monitorimin e konsultimit publik të 50 akteve të 10 institucioneve të qeverisjes qendrore.

5. Parimet e konsultimit publik

Instrumenti metodologjik është ngritur mbi gjashtë parime thelbësore të procesit të konsultimit publik. Për secilin prej këtyre parimeve është hartuar lista e treguesve të monitorimit si më poshtë, duke përcaktuar gjithashtu për secilin tregues nëse vlerësohet për çdo akt apo vetëm një herë në nivel institucioni. Disa tregues vlerësohen në nivel vjetor, në varësi të numrit të viteve të mbuluara nga monitorimi.

I. Parimi i Transparencës, për vlerësimin e të cilit kontrollohet publikimi proaktiv i:

- Paketës së dokumenteve mbështetëse të konsultimit publik;
- Planit vjetor të konsultimit publik;
- Planit individual të konsultimit publik;
- Komenteve të mbledhura sipas të gjitha metodave të konsultimit publik;
- Raportit 6-mujor dhe raportit vjetor të konsultimit publik;
- Raportit individual të konsultimit publik.

Treguesit e parimit të transparencës vlerësojnë vetëm informacionin e publikuar në mënyrë proaktive. Ndërkohë, treguesit e parimeve të tjera vlerësojnë edhe përmbajtjen e dokumenteve dhe mund të bazohen edhe në të dhëna të vëna në dispozicion nëpërmjet kërkesës për informim.

II. Parimi i aksesueshmërisë, për vlerësimin e të cilit kontrollohet:

- Niveli i aksesueshmërisë së njoftimit për konsultimin publik dhe kanaleve nëpërmjet të cilave është shpërndarë;
- Niveli i aksesueshmërisë së draft aktit dhe dokumenteve të tjera mbështetëse të konsultimit publik.

III. Parimi i efektivitetit, për vlerësimin e të cilit kontrollohen elemente si:

- Afati i konsultimit;
- Njoftimet e konsultimit të projektakteve;
- Miratimi i akteve brenda vitit kalendarik;
- Realizimi i planit vjetor të konsultimeve publike;
- Monitorimi i efektivitetit të metodave dhe pjesëmarrjes në konsultime;
- Monitorimi dhe vlerësimi i brendshëm i procesit të konsultimit publik.

IV. Parimi i llogaridhënies, për vlerësimin e të cilit kontrollohen elemente si:

- Informacioni mbi fazën e hartimit të aktit ose të konsultimit paraprak;
- Planifikimi i projektaktit në PPAP/PKIE/dokument tjetër strategjik;
- Planifikimi i projektaktit në planin vjetor të konsultimeve publike;
- Argumentimi i arsyeve të refuzimit ose pranimit të pjesshëm për komentet;
- Vënia në dispozicion e procedurave të ankimit për qytetarët në lidhje me procesin e konsultimit publik;
- Argumentimi i përjashtimit të akteve të caktuara nga konsultimi publik;

- Sqarimi i ndikimit të konsultimit publik tek Raporti RIA.

V. Parimi i gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit, për vlerësimin e të cilit kontrollohen elementë si:

- Identifikimi i grupeve të prekura nga vendimmarrja, grupeve të mundshme të interesit, grupeve të cenueshme;
- Larmia ose diversiteti i grupeve që kanë marrë pjesë në procesin e hartimit të projektaktit;
- Larmia ose diversiteti i grupeve që kanë marrë pjesë në procesin e konsultimit publik;
- Përshtatshmëria e metodave të përzgjedhura të konsultimit.

VI. Parimi i pjesëmarrjes qytetare, për vlerësimin e të cilit kontrollohen elemente si:

- Lista institucionale e ekspertëve dhe grupeve të interesit;
- Numri i aktorëve jo-qeveritarë që kanë marrë pjesë në procesin e hartimit të akteve në nivel vjetor;
- Numri i aktorëve jo-qeveritarë që kanë marrë pjesë në konsultim publik në nivel vjetor;
- Numri i pjesëmarrësve kontribuues në procesin e konsultimit në nivel vjetor;
- Numri i komenteve të gjeneruara në procesin e konsultimit në nivel vjetor;
- Plotësia dhe disagregimi i të dhënave për pjesëmarrjen qytetare në konsultimin e projektaktit;
- Plotësia dhe disagregimi i të dhënave vjetore për pjesëmarrjen qytetare në konsultimet publike.

6. Procesi i përzgjedhjes së institucioneve dhe akteve objekt monitorimi

Instrumenti metodologjik u pilotua nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim gjatë vitit 2024. Në monitorim u përfshinë 10 institucione të qeverisjes qendrore, të cilat përfaqësojnë më shumë se gjysmën (56%) e institucioneve që kanë kryer konsultime publike gjatë periudhës 2022-2023. Për secilin prej institucioneve u monitorua një numër i njëjtë aktesh (pesë). Pra, në total u monitoruan 50 akte, të cilat janë konsultuar gjatë periudhës 2022-2023; 19 prej të cilave ishin dokumente strategjike ose vendime të Këshillit të Ministrave, ndërsa 31 ishin projektligje. Kampioni i akteve të përzgjedhura për monitorim përbën 62% të mesatares vjetore të akteve të konsultuara gjatë 2022- 2023.

Në kontekstin metodologjik, u zbatuan kriteret e mëposhtme për përzgjedhjen e institucioneve dhe akteve objekt monitorimi.


Kriteret për përzgjedhjen e institucioneve

Kriteri 1: Volumi i veprimtarisë ligj hartuese/politikëbërëse të institucionit

Ky kriter merr në konsideratë numrin e përgjithshëm të nismave ligjore e nënligjore të ndërmarra nga institucioni publik, të parashikuara në Planin Vjetor të Konsultimit Publik, Planin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP), Planin Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE), si dhe dokumente të tjera strategjike. Kjo i shërben krijimit të një baze të gjerë të dhënash duke rritur mundësitë për përzgjedhje cilësore ndërmjet projektakteve që institucionet me nivele të larta aktiviteti kanë konsultuar ose duhej të kishin konsultuar, bazuar në legjislacionin përkatës. Në këtë kuptim, numri më i lartë i propozimeve është tregues i një institucioni aktiv, duke nënkuptuar se veprimtaria e tij politikëbërëse ka ndikim më të madh në jetën e qytetarëve dhe për rrjedhojë, edhe interes publik të shtuar për procesin e konsultimit.

Kriteri 2: Shpeshësia e konsultimeve publike të mbajtura nga institucioni

Ky kriter merr në konsideratë sa shpesh e angazhon institucioni publikun në proceset e tij vendimmarrëse. Kjo i shërben krijimit të një baze të dhënash të



proceseve faktike të konsultimit publik që janë organizuar gjatë një viti të caktuar dhe bën të mundur identifikimin dhe analizimin e praktikave të ndjekura në mënyrë sistematike.

Kriteri 3: Gjerësia e fushës së përgjegjësisë së institucionit

Në këtë kriter merret parasysh ndikimi i veprimtarisë së institucionit tek publiku. Pavarësisht se të gjithë institucionet publike kanë rëndësi në rregullimin e marrëdhënieve shoqërore, disa prej tyre për shkak të fushës së gjerë të përgjegjësisë prodhojnë akte ligjore e nënligjore të larmishme duke ndikuar tek një popullatë e madhe dhe në sektorë të ndryshëm.

Kriteri 4: Interesi i aktorëve jo qeveritarë dhe publikut në aktivitetin e institucionit

Ky kriter lidhet me reagimin publik, ndjeshmëritë dhe shqetësimet e identifikuara dhe angazhimin në proceset vendimmarrëse të institucionit si nga palët e interesuara që preken nga projektaktet ashtu edhe nga publiku i gjerë. Ky reagim i publikut sugjeron se vendimet e institucionit janë me interes të lartë publik dhe për rrjedhojë, janë tregues për nevojën dhe interesin e shtuar për konsultim publik.

Kriteri 5: Diversiteti i natyrës dhe funksioneve të institucioneve të qeverisjes qendrore

Ky kriter synon të sigurojë diversitet në kampionimin e institucioneve të monitoruara, duke siguruar që përveç institucioneve me fushë të gjerë përgjegjësie, të përfshihen në monitorim edhe disa institucione që mbulojnë fusha më specifike përgjegjësie, apo agjenci të qeverisjes qendrore.


Kriteri 6: Përfaqësueshmëria e institucioneve të qeverisjes qendrore

Kampioni i institucioneve të përzgjedhura për monitorim (10), përfaqëson më shumë se gjysmën (56%) e numrit mesatar të institucioneve që kanë kryer konsultimeve publike gjatë 2022-2023.

Kriteret për përzgjedhjen e akteve

Kriteri 1: Rëndësia strategjike a projektaktit

Ky kriter siguron që disa nga aktet e përzgjedhura të jenë akte ligjore ose nënligjore me rëndësi strategjike. Akte me rëndësi strategjike konsiderohen ato të parashikuara në



Planin Kombëtar të Integritimit Evropian, programin e qeverisë, strategjitë sektoriale, akte që synojnë ndërmarrjen e reformave të caktuara etj.

Kriteri 2: Interesi publik i gjeneruar nga projektakti

Ky kriter merr në konsideratë reagimin dhe interesimin e publikut ndaj aktit, duke përfshirë komentet dhe mendimet që jepen në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik. Edhe pse ky regjistër nuk njihet/përdoret gjerësisht nga qytetarët, mund të mendohet që një akt që ka gjeneruar komente të shumta ka pasur ndjeshmëri të caktuar. Ky kriter merr parasysh edhe sugjerimet e bëra për aktin në kanale të tjera publike si dhe interesin që ka treguar media, përfshirë këtu edhe rastet kur pavarësisht kësaj, institucioni nuk e ka publikuar aktin për konsultim.

Kriteri 3: Diversiteti i natyrës dhe përmbajtjes së projektaktit

Në kriterin 3 synohet një përzgjedhje sa më gjithëpërfshirëse e projektakteve të monitoruara, duke marrë parasysh llojin dhe përmbajtjen e projektaktit të propozuar. Në këtë kuadër, bëhet e mundur që projektaktet e monitoruara të variojnë nga ato më tekniket, konsultimi i të cilave i drejtohet ekspertëve dhe palëve të interesuara që zotërojnë njohuritë e nevojshme në një fushë të caktuar, tek akte me natyrë të përgjithshme që kërkojnë njohuri mesatare për të kuptuar ndikimin e propozimeve. Gjithashtu, ky kriter siguron që në kampionimin e projektakteve, përveç projektligjeve, të përfshihen edhe Vendime të Këshillit të Ministrave, projekt-dokumente strategjike kombëtare dhe politika me interes të lartë publik.

Kriteri 4: Ndikimi i projektaktit në grupe të caktuara të popullsisë

Ky kriter merr në konsideratë ekzistencën dhe ndjeshmëritë e grupeve të caktuara që lidhen me vendimmarrjen, duke përfshirë: grupe sociale/ekonomike/minoritare të prekura nga projektakti; grupe të lidhura apo të specializuara në fushën e rregulluar nga projektakti; grupe që do të përfshihen në zbatimin e projektaktit; grupe për të cilat projektakti prodhon detyrime ose kufizime të reja.

Kriteri 5: Përfaqësueshmëria në raport me mesataren vjetore të akteve të konsultuara

Kampioni i akteve të përzgjedhura (50) për monitorim përfaqëson më shumë se gjysmën (62%) e mesatares vjetore akteve të konsultuara gjatë 2022-2023.

7. Mbledhja e të dhënave

Mbledhja e të dhënave do të kryhet nëpërmjet dy instrumenteve kryesore:

1. Shqyrtimi i dokumentacionit

Shqyrtimi i dokumentacionit përfshin konsultimin e burimeve të informacionit të disponueshëm publikisht si për shembull:

- Regjistri Elektronik i Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENJK);
- Faqet zyrtare të institucioneve publike që do të monitorohen;
- Programet e Transparencës, si pjesë e faqes zyrtare të institucioneve publike;
- Fletorja Zyrtare (vitet 2022-2023);
- Plani Kombëtar i Integritimit Evropian 2022-2024;
- Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve (vitet 2022-2023).

Literatura e rekomanduar për monitoruesit gjendet në Shtojcën 2, ndërsa lista e dokumenteve që janë objekt vlerësimi si dhe baza ligjore së bashku me lidhjen me treguesit gjenden në Shtojcën 3.

2. Kërkesat për informim

Duke qenë se metodologjia përfshin monitorimin e disa kategorive të informacionit që nuk janë të detyrueshme për t'u publikuar nga autoritetet publike, për mbledhjen e të dhënave do të përdoren edhe kërkesat zyrtare për informim, drejtuar institucioneve që monitorohen.

Në Shtojcën 4 të metodologjisë jepen udhëzimet për hartimin e kërkesave për informacion si dhe renditen disa nga kategoritë e informacionit që nuk publikohen proaktivisht në praktikë ose nuk janë të detyrueshme për t'u publikuar. Këto kategori informacioni rekomandohet të përfshihen në kërkesën për informim. Për qartësi, kategoritë e informacionit në fjalë janë organizuar sipas treguesve të metodologjisë që do të monitorohen.

Me përfundimin e mbledhjes së të dhënave, monitoruesit vijojnë me verifikimin e përputhshmërinë së proceseve të konsultimit të kryera nga institucionet e monitoruara me kërkesat ligjore dhe nënligjore, duke vlerësuar me pikë performancën për secilin tregues.

8. Sistemi i pikëzimit të treguesve

Ky instrument monitorimi përcakton që çdo tregues mund të vlerësohet me 0, 1 dhe 2 pikë, në bazë të informacionit që rezulton lidhur me të nga monitorimi. Kriteret mbi të cilat bazohet vlerësimi me pikë për çdo tregues përshkruhen me hollësi në Shtojcën 1 "Matrica e vlerësimit sipas treguesve".

Në pikëzim, siç theksohet më lart, merren në konsideratë treguesit që vlerësohen vetëm një herë dhe treguesit që vlerësohen për secilin nga 5 aktet objekt monitorimi. Për shembull, nëse jemi duke vlerësuar parimin e transparencës për institucionin X, atëherë vlerësimi maksimal për të do të jetë:

2 tregues që vlerësohen në nivel vjetor (pra, 2 herë për vitet 2022 dhe 2023): (treguesit 1.2/1.5) x 2 pikë x 2 vite = 2 x 2 x 2 = 8 pikë.

4 tregues që vlerësohen për 5 akte nga 2 pikë secili: 4 x 5 x 2 pikë = 40 pikë
Vlerësimi maksimal: 48 pikë

I njëjti sistem ndiqet edhe për parimet e tjera.

Referuar gjashtë parimeve të detajuara më sipër maksimumi i pikëve që mund të merren nga çdo institucion llogaritet si më poshtë:

Parimi 1: Transparenca

*Numri maksimal i pikëve lidhur me këtë parim për 1 akt të konsultuar është **8 pikë**. Ndërkohë në nivel institucioni, duke marrë në konsideratë treguesit që vlerësohen në nivel vjetor/1 herë për secilin vit dhe ata që vlerësohen për çdo akt të monitoruar, numri maksimal i pikëve që mund të marrë një institucion është **48 pikë**.*

Parimi 2: Aksesueshmëria

*Numri maksimal i pikëve lidhur me këtë parim për 1 akt të konsultuar është **4 pikë**. Ndërkohë në nivel institucioni, duke marrë në konsideratë të gjitha aktet objekt monitorimi, numri maksimal i pikëve që mund të marrë një institucion është **20 pikë**.*

Parimi 3: Efektiviteti

*Numri maksimal i pikëve lidhur me këtë parim për 1 akt të konsultuar është **2 pikë**. Ndërkohë në nivel institucioni, duke marrë në konsideratë treguesit që vlerësohen në*



*nivel vjetor/vetëm 1 herë dhe ata që vlerësohen për çdo akt të monitoruar, numri maksimal i pikëve që mund të marrë një institucion është **26 pikë**.*

Parimi 4: Llogaridhënia

*Numri maksimal i pikëve lidhur me këtë parim për 1 akt të konsultuar është **8 pikë**. Ndërkohë në nivel institucioni, duke marrë në konsideratë treguesit që vlerësohen në nivel vjetor/vetëm 1 herë dhe ata që vlerësohen për çdo akt të monitoruar, numri maksimal i pikëve që mund të marrë një institucion është **46 pikë**.*

Parimi 5: Mosdiskriminimi dhe gjithëpërfshirja

*Numri maksimal i pikëve lidhur me këtë parim për 1 akt të konsultuar është **8 pikë**. Ndërkohë në nivel institucioni, duke marrë në konsideratë treguesit që vlerësohen në nivel vjetor/vetëm 1 herë dhe ata që vlerësohen për çdo akt të monitoruar, numri maksimal i pikëve që mund të marrë një institucion është **40 pikë**.*

Parimi 6: Pjesëmarrja qytetare

*Numri maksimal i pikëve lidhur me këtë parim për 1 akt të konsultuar është **2 pikë**. Ndërkohë në nivel institucioni, duke marrë në konsideratë treguesit që vlerësohen në nivel vjetor vetëm 1 herë dhe ata që vlerësohen për çdo akt të monitoruar, numri maksimal i pikëve që mund të marrë një institucion është **32 pikë**.*

9. Vlerësimi i performancës së institucioneve në realizimin e procesit të konsultimit publik

Sistemi i pikëzimit i sqaruar më sipër mund të shërbejë për të parë jo vetëm pikët totale të secilit institucion, por dhe për t'i krahasuar institucionet ndërmjet tyre. Gjatë monitorimit të procesit të konsultimit do të llogaritet dhe indeksi i konsultimit publik, që është raporti midis rezultatit të pikëzimit që del nga monitorimi me maksimalen e mundshme të pikëve për çdo institucion.

Duke përdorur tabelën e shkallëzuar të sistemit të matjes së zbatimit të konsultimit publik në nivel qendror, bëhet specifikimi relativ i shkallës së zbatimit të procesit të konsultimit publik.

Në tabelën e mëposhtme jepet një ndarje e shkallëve të performancës në 3 grupe:

1. Performancë e ulët;
2. Performancë mesatare;
3. Performancë e lartë.

Tabela 1. Ndarja e shkallës së performancës

Numri total i pikëve të mbledhura	Niveli i performancës institucionale	Përqindja e pikëve ndaj totalit	Maksimumi i pikëve të mundshme
Më pak se 84.8 pikë	Nivel i ulët	Nën 40%	212 pikë
84.8 -169.6 pikë	Nivel i mesëm	41%-80%	
Mbi 169.6 pikë	Nivel i lartë	Mbi 80%	

Ky sistem vlerësimi bën të mundur që shkalla e performancës të matet edhe për secilin prej parimeve sipas tabelës më poshtë.

Për një panoramë më të plotë, në tabelën e mëposhtme paraqitet sistemi i vlerësimit dhe shkalla e performancës sipas pikëve:

Tabela 2. Sistemi i vlerësimit dhe shkalla e performancës sipas pikëve

Parimi	Numri i treguesit	Totali i pikëve të mundshme për tregues	Pikët totale sipas parimit	Kategorizimi në nivel performance		
				Nivel i lartë (mbi 80%)	Nivel i mesëm (40%-80%)	Nivel i ulët (nën 40%)
Transparenca	1.1	10	48 pikë	Mbi 38.4 pikë	Ndërmjet 19.2 - 38.4 pikë	Nën 19.2 pikë
	1.2	4				
	1.3	10				
	1.4	10				
	1.5	4				
	1.6	10				
Aksesueshmëria	2.1	10	20 pikë	Mbi 16.0 pikë	Ndërmjet 8-16 pikë	Nën 8.0 pikë
	2.2	10				
Efektiviteti	3.1	10	26 pikë	Mbi 20.8 pikë	Ndërmjet 10.4- 20.8 pikë	Nën 10.4 pikë
	3.2	4				
	3.3	4				
	3.4	4				
	3.5	2				
	3.6	2				
Llogaridhënia	4.1	10	46 pikë	Mbi 36.8 pikë	Ndërmjet 18.4- 36.8 pikë	Nën 18.4 pikë
	4.2	10				
	4.3	10				
	4.4	2				
	4.5	4				
	4.6	10				
Mosdiskriminimi dhe gjithëpërfshirja	5.1	10	40 pikë	Mbi 32.0 pikë	Ndërmjet 16-32 pikë	Nën 16 pikë
	5.2	10				
	5.3	10				
	5.4	10				
Pjesëmarrja qytetare	6.1	2	32 pikë	Mbi 25.6 pikë	Ndërmjet 12.8- 25.6 pikë	Nën 12.8 pikë
	6.2	4				
	6.3	4				
	6.4	4				
	6.5	4				
	6.6	10				
	6.7	4				

10. Shtojcat

Shtojca 1. Matrica e vlerësimit sipas treguesve

Parimi I: Transparenca

Treguesi	Vlerësimi
1.1 Paketa e dokumenteve mbështetëse të konsultimit publik të aktit të monitoruar është publikuar.	0 pikë: Paketa e dokumenteve mbështetëse nuk është publikuar/Është publikuar vetëm draft akti. 1 pikë: Janë publikuar draft akti dhe/ose relacioni/mungojnë shumica e dokumenteve mbështetëse. 2 pikë: Janë publikuar draft akti, relacioni, RIA, tabela e përputhshmërisë, dokumente të tjera orientuese.
1.2 Plani vjetor i konsultimit publik është publikuar dhe është i plotë.	0 pikë: Plani vjetor nuk është publikuar 1 pikë: Plani vjetor është publikuar, por nuk është i plotë. (Nuk përmban 1 ose më shumë elementë të përcaktuar në udhëzuesin e konsultimit publik.) 2 pikë: Plani vjetor është publikuar dhe është i plotë.
1.3 Plani individual i konsultimit publik është publikuar dhe është i plotë.	0 pikë: Plani individual nuk është publikuar. 1 pikë: Plani individual është publikuar, por nuk është i plotë. (Mungojnë një ose më shumë elementë të përcaktuar në udhëzuesin e konsultimit publik.) 2 pikë: Plani individual është publikuar dhe është i plotë.
1.4 Institucioni ka publikuar të gjitha komentet e mbledhura sipas të	0 pikë: Institucioni nuk ka publikuar komentet e mbledhura gjatë konsultimit/nuk ka sqaruar

Treguesi	Vlerësimi
<p>gjitha metodave të konsultimit publik, në një mënyrë që lejon identifikimin e grupeve të ndryshme të interesit që kanë kontribuar/sqaron që nuk ka komente.</p>	<p>që nuk ka pasur asnjë koment dhe arsyet e mundshme.</p> <p>1 pikë: Institucioni ka publikuar vetëm komentet e mbledhura nga një metodë e vetme konsultimi (jo metodat e tjera të përdorura), por nuk identifikon qartë grupet e interesit që kanë kontribuar, ose e anasjellta/Ka sqaruar që nuk ka pasur komente pa analizuar arsytet.</p> <p>2 pikë: Institucioni ka publikuar komentet e mbledhura me të gjitha metodat e përdorura dhe identifikon qartë grupet e interesit që kanë kontribuar/ka sqaruar që nuk ka pasur asnjë koment duke analizuar arsytet e mundshme.</p>
<p>1.5 Raporti 6-mujor dhe vjetor i konsultimit publik janë publikuar dhe janë të plotë.</p>	<p>0 pikë: Raporti vjetor dhe 6-mujor nuk janë publikuar.</p> <p>1 pikë: Është hartuar/publikuar vetëm njëri nga raportet/ose janë publikuar të dy, por nuk janë të plotë.</p> <p>2 pikë: Raporti vjetor dhe 6-mujor janë publikuar dhe janë të plotë.</p>
<p>1.6 Raporti individual i konsultimit publik është publikuar dhe është i plotë.</p>	<p>0 pikë: Raporti individual nuk është publikuar.</p> <p>1 pikë: Raporti individual është publikuar, por nuk është i plotë.</p> <p>2 pikë: Raporti individual është publikuar dhe është i plotë.</p>

Parimi II: Aksesueshmëria

Treguesi	Vlerësimi
2.1 Njoftimi për konsultimin publik është shpërndarë përmes RENJKP dhe të paktën një kanal tjetër komunikimi dhe është i plotë.	0 pikë: Konsultimi nuk është njoftuar, ose është njoftuar vetëm përmes RENJKP. 1 pikë: Konsultimi është njoftuar përmes RENJKP dhe të paktën një kanal tjetër, por nuk përmban informacion të plotë (p.sh. informacionin logjistik, datën, vendin, orën e takimit etj.). 2 pikë: Konsultimi është njoftuar përmes RENJKP dhe të paktën një kanal tjetër dhe përmban të gjithë informacionin e nevojshëm.
2.2 Draft akti dhe dokumentet e tjera mbështetëse janë të aksesueshme, në një format lehtësisht të ripërdorshëm dhe sipas rastit në formatin e të dhënave të hapura.	0 pikë: Projektakti dhe dokumentet mbështetëse gjenden si kategori informacioni, por nuk janë të aksesueshëm/ripërdorshëm/ Asnjë dokument nuk është i aksesueshëm /ripërdorshëm. 1 pikë: Draft akti dhe/ose një pjesë e dokumenteve mbështetëse janë të aksesueshme/Draft akti dhe/ose dokumentet mbështetëse janë të aksesueshëm /ripërdorshëm, por gjenden me vështirësi dhe/ose/nuk janë në formatin e të dhënave të hapura kur është rasti. 2 pikë: Draft akti dhe të gjithë dokumentet mbështetëse janë të aksesueshme, të ripërdorshme dhe në formatin e të dhënave të hapura kur është rasti.

Parimi III: Efektiviteti

Treguesi	Vlerësimi
3.1 Afati i konsultimit respekton minimumin ligjor, është realist dhe merr parasysh natyrën dhe kompleksitetin e projektaktit objekt konsultimi.	<p>0 pikë: Afati i konsultimit është më pak se 20 ditë pune, nuk respekton afatin minimal sipas ligjit/pushimet zyrtare.</p> <p>1 pikë: Afati i konsultimit është 20 ditë pune/respekton afatin minimal sipas ligjit në mënyrë standarde, por nuk është realist/nuk merr parasysh natyrën dhe kompleksitetin e projektaktit objekt konsultimi.</p> <p>2 pikë: Afati i konsultimi është realist, sepse në dokumentet mbështetës institucioni ka treguar që ka marrë parasysh natyrën dhe kompleksitetin e projektaktit objekt konsultimi/ose institucioni ka treguar proaktivitet duke zgjatur/shtyrë/përsëritur procesin e konsultimit publik. (Afati do të vlerësohet lidhur me gjatësinë e projektaktit (nr. faqe), kompleksitetin, llojin e aktit (p.sh., dokument strategjik ose politikash, projektligje të veçanta, p.sh., kodet, projektligje që miratohen me shumicë të cilësuar, draft akte që lidhen me reformimin e fushave të ndryshme, etj.).</p> <p><i>Shënim: Për dokumentet e shkurtra (p.sh., deri në 20 faqe), një periudhë konsultimi prej rreth 2 deri në 4 javë mund të jetë e mjaftueshme.</i></p> <p><i>Për dokumentet me volum mesatar (p.sh., 20 deri në 50 faqe), një periudhë konsultimi prej rreth 4 deri në 6 javë mund të jetë e arsyeshme.</i></p> <p><i>Për dokumentet më të gjata (p.sh., mbi 50 faqe), një periudhë konsultimi prej 6 deri në 8 javë ose më shumë mund të jetë e nevojshme. Kjo i referohet të gjithë paketës së</i></p>

Treguesi	Vlerësimi
	<i>dokumenteve që publikohet para procesit të konsultimit.</i>
3.2 Njoftimet e konsultimit të projektakteve janë shpërndarë në mënyrë të arsyeshme përgjatë vitit.	<p>0 pikë: Konsultimet publike janë shumë të përqendruara në muaj ose periudha të veçanta të vitit, me pak ose aspak aktivitet në periudha të tjera/Institucioni ka kryer konsultime të mbivendosura/gjatë periudhave të pushimeve/festave zyrtare.</p> <p>1 pikë: Konsultimet publike janë pak të përqendruara në muaj ose periudha të caktuara, por tregojnë një farë niveli të shpërndarjes përgjatë vitit kalendarik.</p> <p>2 pikë: Konsultimet publike janë shpërndarë në mënyrë të barabartë ose proporcionale përgjatë vitit kalendarik, me një nivel të qëndrueshëm aktiviteti të mbajtur gjatë muajve ose periudhave të ndryshme.</p>
3.3 Aktet e konsultuara janë miratuar brenda vitit kalendarik.	<p>0 pikë: Më pak se 50% e akteve të konsultuara janë miratuar brenda vitit kalendarik.</p> <p>1 pikë: 50-80% e akteve të konsultuara janë miratuar brenda vitit kalendarik.</p> <p>2 pikë: Më shumë se 80% e akteve të konsultuara janë miratuar brenda vitit kalendarik.</p>
3.4 Institucioni ka realizuar planin vjetor të konsultimeve publike.	<p>0 pikë: Më pak se 50% e akteve të planifikuara në Planin Vjetor të Konsultimit, janë konsultuar brenda vitit kalendarik.</p> <p>1 pikë: 50-80% e akteve të planifikuara në Planin Vjetor të Konsultimit, janë konsultuar brenda vitit kalendarik.</p> <p>2 pikë: Më shumë se 80% e akteve të planifikuara në Planin Vjetor të Konsultimit, janë konsultuar brenda vitit kalendarik.</p>

Treguesi	Vlerësimi
<p>3.5 Institucioni ka vlerësuar efektivitetin e metodave dhe pjesëmarrjes në konsultime.</p>	<p>0 pikë: Institucioni nuk ka vlerësuar efektivitetin e metodave dhe pjesëmarrjes në konsultime publike.</p> <p>1 pikë: Institucioni ka vlerësuar efektivitetin e metodave dhe pjesëmarrjes në konsultime publike, por nuk ka publikuar rezultatet/përfundimet.</p> <p>2 pikë: Institucioni ka vlerësuar efektivitetin e metodave dhe pjesëmarrjes në konsultime publike dhe ka publikuar rezultatet/përfundimet.</p>
<p>3.6 Institucioni ka monitoruar procesin e konsultimit publik.</p>	<p>0 pikë: Institucioni nuk ka hartuar/publikuar një raport monitorimi për procesin e konsultimit publik.</p> <p>1 pikë: Institucioni ka hartuar një raport monitorimi për procesin e konsultimit publik, por nuk e ka publikuar.</p> <p>2 pikë: Institucioni ka hartuar / publikuar një raport të plotë monitorimi për procesin e konsultimit publik.</p>

Parimi IV: Llogaridhënia

Treguesi	Vlerësimi
4.1 Institucioni ka raportuar për fazën e hartimit të aktit / konsultimin paraprak.	0 pikë: Institucioni nuk ka raportuar për fazën e hartimit të aktit dhe/ose konsultimin paraprak. 1 pikë: Institucioni ka raportuar për fazën e hartimit të aktit dhe/ose për konsultimin paraprak kur ka pasur të tillë, por informacioni nuk është i plotë (p.sh., mungon informacion për përbërjen e grupit të punës, pjesëmarrësit jo qeveritarë në konsultim paraprak kur ka pasur etj.) 2 pikë: Institucioni ka raportuar për fazën e hartimit të aktit duke përfshirë informacion për institucionin propozues, grupin e punës për hartimin e aktit, si dhe informacion të plotë mbi konsultimin paraprak kur ka pasur të tillë.
4.2 Projektakti i konsultuar ka qenë i planifikuar në PPAP/PKIE/dokument tjetër strategjik dhe Planin Vjetor të Konsultimeve Publike.	0 pikë: Projektakti nuk ka qenë i planifikuar në PPAP/PKIE/dokument tjetër strategjik dhe nuk ka qenë i planifikuar në Planin Vjetor të Konsultimeve Publike (nuk identifikohet origjina e tij)s. 1 pikë: Projektakti ka qenë i planifikuar në PPAP/PKIE/dokument tjetër strategjik, por jo në Planin Vjetor të Konsultimeve, ose e anasjellta. 2 pikë: Projektakti ka qenë i planifikuar në PPAP/PKIE/dokument tjetër strategjik dhe Planin Vjetor të Konsultimeve Publike.
4.3 Institucioni ka argumentuar arsyet e refuzimit / pranimit të pjesshëm për çdo koment dhe në rast të pranimit të tyre ka	0 pikë: Institucioni nuk ka hartuar tabelën e komenteve të shoqëruar me shpjegimet përkatëse/ referimet e dispozitave ku janë reflektuar komentet e pranuar dhe/ose nuk i është përgjigjur komenteve publike në

Treguesi	Vlerësimi
referuar dispozitat ku ato gjejnë reflektim.	<p>RENJKP/nuk ka sqaruar masat e marra për mungesën e komenteve kur nuk kishte të tilla.</p> <p>1 pikë: Institucioni ka hartuar tabelën e komenteve në mënyrë të pjesshme, por shpjegimet e dhëna nuk janë të argumentuara/nuk janë bërë referimet e dispozitave ku janë reflektuar komentet e pranuar/Ka sqaruar në mënyrë të përgjithshme masat e marra për mungesën e komenteve kur nuk kishte të tilla.</p> <p>2 pikë: Institucioni ka hartuar tabelën e komenteve në mënyrë të plotë, ka dhënë shpjegime të argumentuara dhe ka bërë referimet e dispozitave ku janë reflektuar komentet e pranuar/ ka sqaruar masat e marra për mungesën e komenteve kur nuk kishte të tilla.</p>
4.4 Institucioni ka publikuar procedura ankimi për qytetarët në lidhje me procesin e konsultimit publik.	<p>0 pikë: Institucioni nuk ka publikuar informacion për procesin e ankimit për publikun, në lidhje me konsultimet e mbajtura prej tij.</p> <p>1 pikë: Institucioni ka publikuar informacion të përgjithshëm për procesin e ankimit, duke përdorur formulimin standard të ligjit përkatës, pa ofruar qartësi mbi procedurën përkatëse të zbatuar prej tij, kontaktin e personit përgjegjës për shqyrtimin e ankimit dhe formularë të dedikuar ankimi.</p> <p>2 pikë: Institucioni ka publikuar procedura të qarta ankimi për qytetarët gjatë procesit të konsultimit publik, formularë të dedikuar ankimi dhe kontaktin e personit përgjegjës për shqyrtimin e ankimit.</p>
4.5 Vlerësimi i përfshirjes dhe përgjashtimit të	<p>0 pikë: Institucioni nuk ka hartuar/publikuar matricën e vlerësimit të</p>

Treguesi	Vlerësimi
<p>akteve nga konsultimi publik është hartuar/publikuar dhe argumentuar.</p>	<p>përfshirjes/përrjashtimit të akteve nga konsultimit publik.</p> <p>1 pikë: Institucioni ka hartuar/publikuar matricën e vlerësimit të përfshirjes/përrjashtimit të akteve nga konsultimit publik, por nuk ka argumentuar arsyet e përrjashtimeve.</p> <p>2 pikë: Institucioni ka hartuar/publikuar matricën e vlerësimit të përfshirjes/përrjashtimit të akteve nga konsultimit publik dhe ka ofruar shpjegimet përkatëse për përrjashtimet.</p>
<p>4.6 Institucioni ka raportuar për ndikimin e konsultimit publik mbi Raportin RIA.</p>	<p>0 pikë: Institucioni nuk ka dhënë informacion për ndikimin e konsultimit publik tek raporti RIA/Nuk ka hartuar RIA.</p> <p>1 pikë: Institucioni ka dhënë informacion për ndikimin e konsultimit publik tek raporti RIA, pa e identifikuar qartë atë.</p> <p>2 pikë: Institucioni ka identifikuar qartë ndikimin/ose mungesën e ndikimit të konsultimit publik në ndryshimin/rishikimin e raportit RIA.</p>

Parimi: Gjithëpërfshirja dhe mosdiskriminimi

Treguesi	Vlerësimi
5.1 Institucioni ka identifikuar paraprakisht grupet e prekura nga vendimmarrja, grupet potenciale të interesit, grupet e cenueshme.	0 pikë Institucioni nuk ka identifikuar grupet e interesit/ nuk hartuar/publikuar matricën e analizës së palëve të interesuara. 1 pikë Institucioni ka identifikuar disa grupe interesi, por nuk ka hartuar/publikuar matricën e analizës së palëve të interesuara. 2 pikë Institucioni ka identifikuar qartë grupet e interesit, si dhe ka hartuar/publikuar matricën e analizës së palëve të interesuara.
5.2 Larmia/Diversiteti i grupeve jo qeveritare/ qytetarëve që kanë marrë pjesë në procesin e hartimit të aktit (p.sh. sektorët privatë, jo fitimprurës, qytetarë, grupe informale etj.).	0 pikë Institucioni nuk ka raportuar për pjesëmarrjen ose jo të grupeve jo qeveritare/qytetarëve në procesin e hartimit të aktit. 1 pikë Institucioni ka raportuar pjesëmarrjen e një grupi të caktuar jo qeveritar/qytetarësh në procesin e hartimit të aktit. 2 pikë Institucioni ka raportuar pjesëmarrjen e disa grupeve jo qeveritare që përfaqësojnë sektorë të ndryshëm/qytetarëve, në procesin e hartimit të aktit.
5.3 Larmia/Diversiteti i grupeve jo-qeveritare/ qytetarëve që kanë marrë pjesë në konsultim publik (p.sh. sektorët privatë, jo fitimprurës, qytetarë, grupe informale etj.).	0 pikë Institucioni nuk ka raportuar pjesëmarrjen e grupeve jo-qeveritare/ qytetarëve në konsultim publik. 1 pikë Institucioni ka raportuar pjesëmarrjen e aktorëve të një sektori të caktuar jo qeveritar/grupi të caktuar qytetarësh, në konsultim publik (palëve kyçe), por jo të palëve dytësore. 2 pikë Institucioni ka raportuar pjesëmarrjen e aktorëve jo qeveritarë që përfaqësojnë sektorë të ndryshëm/qytetarëve, në konsultim publik (palët kyçe dhe dytësore).

Treguesi	Vlerësimi
<p>5.4 Metodatat e konsultimit të përzgjedhura janë ato që përshtaten më mirë me çështjen në fjalë, objektivat e përcaktuara dhe janë të përshtatura për të mundësuar pjesëmarrjen e palëve të identifikuar të interesit.</p>	<p>0 pikë Metoda e përzgjedhur e konsultimit publik është standarde, nuk tregon përpjekje për të personalizuar procesin/akomoduar nevojat dhe kapacitetet e palëve të identifikuar të interesit, për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre.</p> <p>1 pikë Metoda e përzgjedhur e konsultimit publik mundëson pjesëmarrjen e disa prej palëve të identifikuar të interesit, por nuk akomodon nevojat dhe kapacitetet e disave prej tyre (p.sh. personat me aftësi të kufizuara, grupime informale etj.)</p> <p>2 pikë Metoda e përzgjedhur e konsultimit publik akomodon nevojat dhe kapacitetet e palëve të identifikuar të interesit dhe mundëson pjesëmarrjen e të gjithëve (palët kyçe dhe dytësore).</p>

Parimi: Pjesëmarrja qytetare

Treguesi	Vlerësimi
6.1 Institucioni ka hartuar listën institucionale të ekspertëve/grupeve të interesit.	0 pikë Institucioni nuk ka hartuar/publikuar listën institucionale të grupeve potenciale të interesit. 1 pikë Institucioni ka publikuar listën institucionale të grupeve potenciale të interesit, por ajo nuk përmban një larmi aktorësh të sektorëve të ndryshëm. 2 pikë Institucioni ka publikuar listën institucionale të grupeve potenciale të interesit dhe ajo përmban një larmi aktorësh të sektorëve të ndryshëm.
6.2 Numri i aktorëve jo-qeveritarë (qytetarëve/ ekspertëve/organizatav e etj.) që kanë marrë pjesë në procesin e hartimit të akteve në nivel vjetor.	0 pikë: Më pak se 50 pjesëmarrës 1 pikë: Ndërmjet 50-99 pjesëmarrës 2 pikë: Më shumë se 100 pjesëmarrës
6.3 Numri i aktorëve jo-qeveritarë (qytetarëve/ ekspertëve/organizatav e etj.) që kanë marrë pjesë në konsultim publik në nivel vjetor.	0 pikë: Më pak se 75 pjesëmarrës 1 pikë: Ndërmjet 75-174 pjesëmarrës 2 pikë: Më shumë se 175 pjesëmarrës
6.4 Numri i pjesëmarrësve kontribuues në konsultime publike në nivel vjetor.	0 pikë: Më pak se 20 pjesëmarrës 1 pikë: Ndërmjet 20-47 pjesëmarrës 2 pikë: Më shumë se 48 pjesëmarrës
6.5 Numri total i komenteve të gjeneruara në konsultime publike në nivel vjetor.	0 pikë: Më pak se 20 komente. 1 pikë: Ndërmjet 20 dhe 49 komente. 2 pikë: 50 ose më shumë komente.

Treguesi	Vlerësimi
<p>6.6 Institucioni ka raportuar të dhëna të plota dhe të disagreguara për pjesëmarrjen qytetare në një konsultim të caktuar (identifikon qartë grupet jo qeveritare të përfshira në proceset e konsultimit publik, natyrën e tyre (diversitetin), numrin e pjesëmarrësve, numrin e pjesëmarrësve kontribuues, duke treguar qartë lidhjen me vendimmarrjen dhe ndikimin e tyre në vendimmarrje.</p>	<p>0 pikë Institucioni nuk ka publikuar të dhëna statistikore për pjesëmarrjen qytetare ose informacion për audiencën e arritur kur nuk ka pasur pjesëmarrje/komente (numri i shikimeve, numri i email-eve të dërguara, etj.).</p> <p>1 pikë Institucioni ka publikuar të dhëna për numrin e pjesëmarrësve, por nuk janë të ndara/nuk tregojnë qartë natyrën e pjesëmarrësve, kontributin e dhënë/ndikimin konkret në proces/ka publikuar informacion për audiencën e arritur/kontaktuar kur nuk ka pasur pjesëmarrës/komente.</p> <p>2 pikë Institucioni ka publikuar të dhëna statistikore të plota dhe të ndara për pjesëmarrjen qytetare, natyrën e aktorëve pjesëmarrës, kontributin dhe ndikimin e tyre në proces//ka publikuar informacion për audiencën e arritur/kontaktuar kur nuk ka pasur komente,duke analizuar edhe mungesën e pjesëmarrjes.</p>
<p>6.7 Institucioni ka raportuar të dhëna vjetore të plota dhe të disagreguara për pjesëmarrjen qytetare (identifikon qartë grupet jo qeveritare të përfshira në proceset e konsultimit publik, natyrën e tyre, diversitetin, numrin e pjesëmarrësve, numrin e pjesëmarrësve kontribuues, duke treguar qartë lidhjen me vendimmarrjen dhe ndikimin e tyre në vendimmarrje.</p>	<p>0 pikë Institucioni nuk ka publikuar të dhëna të plota dhe të ndara vjetore për pjesëmarrjen qytetare.</p> <p>1 pikë Institucioni ka publikuar të dhëna vjetore për numrin e pjesëmarrësve dhe natyrën e tyre, por nuk paraqet kontributin e dhënë/ndikimin në proces.</p> <p>2 pikë Institucioni ka publikuar të dhëna të plota dhe të ndara vjetore për pjesëmarrjen qytetare, natyrën e aktorëve pjesëmarrës, kontributin dhe ndikimin e tyre në proces.</p>



Shtojca 2. Literatura e rekomanduar

- Ligji Nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik"
<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>
- Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"
<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/09/18/119>
- Ligji Nr. 33, datë 31.3/2022, "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik"
<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2022/03/31/33/e24acf1b-16c2-4fbb-8a8a-b2e26fc2ca94;q=P%C3%ABr%20t%C3%AB%20dh%C3%ABnat%20e%20hapura%20dhe%20rip%C3%ABrdorimin%20e%20informacionit%20t%C3%AB%20>
- Urdhri i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, Nr. 3/2021, "Për miratimin e udhëzuesit për procesin e konsultimit publik"
<https://www.adisa.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/URDHER-Nr.-3-Dt.-29.01.2021-compressed.pdf>
- Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 584, datë 28.8.2003, "Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave"
<https://qbz.gov.al/preview/802bebee-2535-47da-9789-c7863c0f5d0f/cons/20240131>
- Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 828/2015, "Për miratimin e rregullave për krijimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të njoftimeve dhe konsultimeve publike"
<https://qbz.gov.al/share/yvëYEPUtRla9p5sH7Jzdza>
- Manuali për Hartimin e Legjislacionit
<https://qbz.gov.al/preview/802bebee-2535-47da-9789-c7863c0f5d0f/cons/20240131>
- Metodologjia për Vlerësimin e Ndikimit Rregullator (RIA)
<https://www.kryeministria.al/wp-content/uploads/2022/06/RIA-Metodologjia.pdf>
- Plani Kombëtar i Integritit Evropian 2022-2024
<https://qbz.gov.al/share/tj8qvNyLS2auocmBcmTRbQ>
- Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve 2022
<https://qbz.gov.al/share/Q-sLyASnT8eNLkISLleKpA>
- Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve 2023
<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/12/27/862/5adae4b4-2162-4b5d-8b42-35b041ae1a0f;q=programi%20%20pergjithshem%20analitik%202022>

- Programi i Qeverisë 2021-2025 https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf
- Faqja zyrtare e ministrisë përkatëse, seksioni i konsultimit publik; shembull: <https://mb.gov.al/konsultime/>
- Faqja zyrtare e ministrisë përkatëse, seksioni i programit të transparencës; shembull: <https://mb.gov.al/programi-i-transparencess/>
- IDM, "Modul Trajnimi: Konsultimi Publik"
<https://idmalbania.org/sq/modul-trajnimi-konsultimi-publik/>
- IDM, Raport Studimor "Një dekadë nga Ligji 'Për Konsultimin Publik': Thirrje për reformë" <https://idmalbania.org/sq/raport-studimor-nje-dekade-nga-ligji-per-konsultimin-publik-ne-shqiperi-thirrje-per-reforme/>

Shtojca 3. Dokumentet objekt vlerësimi, baza ligjore dhe lidhja me treguesit

Nr.	Emërtimi i dokumentit	Detyrimi për hartimin/publikimin	Shërben për vlerësimin e treguesve të mëposhtëm	Verifikohet në nivel institucioni/n ë nivel akti	Baza ligjore/nënligjore që përcakton detyrimin /përbajtjen e dokumentit
1	Raporti vjetor i konsultimit publik	Ka detyrim për publikim (ligji).	1.5; 3.4; 4.6; 5.2; 5.3; 6.2; 6.3; 6.4; 6.5; 6.7.	Në nivel institucioni	Neni 20 i ligjit; Udhëzuesi për konsultimin publik (faqet 27-30 dhe 48)
2	Raporti 6-mujor i konsultimit publik	Ka detyrim për publikim (udhëzuesi).	1.5; 3.4; 4.6; 5.2; 5.3; 6.6.	Në nivel institucioni	Udhëzuesi për konsultimin publik (faqet 27-30 dhe 48)
3	Raporti individual i konsultimit publik	Ka detyrim për publikim (udhëzuesi).	1.6; 3.1; 4.6; 5.2; 5.3; 6.6	Për çdo akt që monitorohet	Udhëzuesi për konsultimin publik (faqet 23-26 dhe 61)
4	Plani vjetor i konsultimit publik	Ka detyrim për publikim (ligji).	1.2; 4.5.	Në nivel institucioni	Neni 6 i ligjit; Udhëzuesi për konsultimin publik (faqet 36, 40-42)
5	Plani individual i konsultimit publik	Ka detyrim për publikim (udhëzuesi).	1.3; 4.1; 3.1.	Për çdo akt që monitorohet	Udhëzuesi për konsultimin publik (faqet 44-45)

Nr.	Emërtimi i dokumentit	Detyrimi për hartimin/publikimin	Shërben për vlerësimin e treguesve të mëposhtëm	Verifikohet në nivel institucioni/në nivel akti	Baza ligjore/nënligjore që përcakton detyrimin /përmbajtjen e dokumentit
6	Raporti i monitorimit të konsultimit publik	Nuk ka detyrim për publikim. (udhëzuesi).	3.5; 3.6.	Në nivel institucioni	Udhëzuesi për konsultimin publik (faqe 44, pika 6, Monitorimi Procesit)
7	Lista/Baza institucionale e të dhënave të grupeve të interesit / lista institucionale e ekspertëve	Parashikohet në udhëzues.	6.1.	Në nivel institucioni	Udhëzuesi për konsultimin publik (faqe 46)
8	Dokumentet mbështetëse për çdo akt të konsultuar: <i>Për projektligjet:</i> - Projektakti që po konsultohet - Relacioni shoqërues - Raporti i Vlerësimin të Ndikimit Rregullator (RIA) - Tabela e Përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së (vetëm për projektaktet relevante)	Detyrimi për hartim/publikim buron nga akte të ndryshme të listuara në kolonën e bazës ligjore.	1.1; 2.2.	Për çdo akt që monitorohet	Neni 13/2 i ligjit, Udhëzuesi, Manuali për Hartimin e Legjislacionit (faqet 159-163); Metodologjia për RIA (faqet 19 dhe 92), Rregullorja e Këshillit të Ministrave (pikat 18, 19, 45).

Nr.	Emërtimi i dokumentit	Detyrimi për hartimin/ publikimin	Shërben për vlerësimin e treguesve të mëposhtëm	Verifikohet në nivel institucioni/n ë nivel akti	Baza ligjore/ nënligjore që përcakton detyrimin /përbajtjen e dokumentit
	<p><i>Për projektvendimet (strategji, politika publike, VKM të tjera):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -Projekt-vendimi (VKM) -Projektakti që po konsultohet - Relacioni shoqërues - Dokumente të tjera mbështetëse të parashikuara/përmendura në dokument (opsionale, mund të jetë buxheti, plani veprimit etj.) 				
9	Njoftimi/ Shënimi shpjegues	Detyrim për njoftim në RENJKP (ligji).	2.1; 3.1.	Për çdo akt që monitorohet	Neni 5, 6, 7 i ligjit; Udhëzuesi i Konsultimit Publik, (faqet 21-22 dhe 46)

Nr.	Emërtimi i dokumentit	Detyrimi për hartimin/publikimin	Shërben për vlerësimin e treguesve të mëposhtëm	Verifikohet në nivel institucioni/në nivel akti	Baza ligjore/nënligjore që përcakton detyrimin/përbajtjen e dokumentit
10	Informacion mbi konsultimet paraprake (konsultim para hartimit) që janë kryer. Raportet e konsultimit paraprak (kur ka pasur).	Nuk ka detyrim për publikimin e raporteve të konsultimeve paraprake. Mbjajtja e këtij lloji të konsultimeve është opsionale (ligji).	4.1; 5.2; 6.2.	Për çdo akt që monitorohet	Nenet 2/7 dhe 12 të ligjit; Udhëzuesi i Konsultimit Publik (faqe 14)
11	Të dhënat statistikore të disagreguara/ Procesverbalet	Ka detyrim për transparencë (ligji dhe cudhëzuesi).	6.2; 6.3; 6.4; 6.5; 5.2; 5.3; 6.6; 6.7.	Në nivel institucioni	Nenet 20 dhe 18/6 të ligjit; Udhëzuesi i Konsultimit Publik (faqja 30)

Nr.	Emërtimi i dokumentit	Detyrimi për hartimin/ publikimin	Shërben për vlerësimin e treguesve të mëposhtëm	Verifikohet në nivel institucioni/n ë nivel akti	Baza ligjore/ nënligjore që përcakton detyrimin /përbajtjen e dokumentit
12	Matrica e analizës së palëve të interesuara	Nuk ka detyrim eksplicit për publikim. Udhëzuesi e parashikon.	5.1.	Për çdo akt që monitorohet	Udhëzuesi i Konsultimit (faqet 14-16)
13	Matrica për aktet e përjashtuara nga konsultimit dhe argumentet përkatëse	Nuk ka detyrim eksplicit për publikim. Udhëzuesi e parashikon si pjesë të planit vjetor.	4.5.	Për çdo akt që monitorohet	Argumentimi i përjashtimit parashikohet në udhëzues si pjesë e Planit Vjetor, faqet 39-40.
14	Tabela e Komenteve	Ka detyrim për publikimin e tyre (ligji dhe udhëzuesi).	1.4; 4.3.	Për çdo akt që monitorohet	Nenet 19, 20 i ligjit; Udhëzuesi i Konsultimit (faqet 24, 50 dhe 51)
15	Skema e analizës së metodave	Nuk ka detyrim eksplicit për publikim	5.4; 3.5.	Për çdo akt që monitorohet	Udhëzuesi i Konsultimit (faqet 17, 18)

Nr.	Emërtimi i dokumentit	Detyrimi për hartimin/ publikimin	Shërben për vlerësimin e treguesve të mëposhtëm	Verifikohet në nivel institucioni/n ë nivel akti	Baza ligjore/ nënligjore që përcakton detyrimin /përbajtjen e dokumentit
		Parashikohet në udhëzues.			
16	Procedurat e ankimit për konsultimin publik	Parashikohen në ligj.	4.4.	Në nivel institucioni	Neni 21 i ligjit

Shtojca 4. Udhëzime për hartimin e kërkesave për informim.

Çdo monitorues bën rishikimin e literaturës për aktet që monitoron. Fillimisht identifikohen dokumentet që nuk janë publikuar nga institucioni dhe që do të kërkohen në bazë të kërkesës për informim.

Sa i përket dokumenteve të publikuar nga institucioni, monitoruesit verifikojnë përmbajtjen e tyre, për të identifikuar nëse të dhënat e kërkuara në tregues të ndryshëm të metodologjisë (shih Shtojcën 3) mungojnë. Për shembull, një raport individual i konsultimit publik, edhe pse gjendet i publikuar, ka mangësi të ndryshme, si, p.sh., mungon tabela e komenteve, mungon numri i pjesëmarrësve, nuk ka qartësi për metodat e konsultimit, etj.

Dokumentet dhe informacioni që nuk gjenden në një nga dokumentet/burimet e përfshira në literaturë kërkohet në bazë të kërkesës për informim. Kërkesa për informim duhet të jetë shteruese dhe të përfshijë të gjithë të dhënat që kërkohen prej një institucioni të caktuar. Kur kërkohet një informacion specifik që mungon në një dokument të publikuar nga institucioni, kjo përcaktohet në mënyrë të qartë në kërkesën që bën monitoruesi. Në kërkesë citohet baza ligjore përkatëse e orientuar nga Shtojca 3.

Më poshtë jepen disa kategori informacioni që nuk publikohen në praktikë/nuk janë të detyrueshme për t'u publikuar, të cilat mund të përfshihen në kërkesë:

Treguesi 2.1 Mjetet e kryerjes së njoftimit për një akt të caktuar dhe evidencat përkatëse.

Treguesi 3.1 Nëse ka pasur zgjatje të afatit për një akt të caktuar dhe arsytet.

Treguesi 3.5 Nëse institucioni ka monitoruar efektivitetin e metodave dhe të pjesëmarrjes (p.sh. me sondazhe të caktuara), rezultatet e monitorimit, masat e marra (skeda e analizës së metodave).

Treguesi 3.6 Nëse institucioni ka kryer monitorim të përgjithshëm 6-mujor ose vjetor të konsultimit publik (kërkohet raporti).

Treguesit 4.1 5.2 Nëse institucioni ka kryer konsultime paraprake, për cilat akte, dhe informacione për institucionin propozues, grupin e punës për hartimin e aktit, aktorët pjesëmarrës jo qeveritare (procesverbali).

Treguesi 4.2 Origjina e një draft akti, kur kjo nuk është e identifikueshme.

Treguesi 4.5 Matrica e përjashtimit të akteve.

Treguesi 4.6 Për aktet me RIA, si ka ndikuar konsultimi publik.

Treguesi 5.1 Matrica e analizës së palëve për çdo akt.

Kërkesat për informacion duhet të bazohen në kuadrin ligjor në fuqi për të drejtën e informimit dhe të dhënat e hapura, konkretisht:

- Ligji 119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar
- Ligji 33/2022, "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik"

Kërkesa për informim duhet të hartohet në përputhje me formatin tip të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kërkesa për informim dërgohet me email, e firmosur dhe me dokumentin e identitetit bashkëlidhur.

[Formatin standard të kërkesës për informacion e merrni duke klikuar këtu.](#)

KËRKESË PËR INFORMACION		
Emër Mbiemër: Z./Znj. _____	Adresa postare: Adresa elektronike: Nr. Tel: _____	Data: ____/____/____ Nënhkrimi: _____
Autoriteti Publik: Adresa: _____ Qyteti: _____		
Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar		
_____ _____ _____ _____		
Të tjera të dhëna		
_____ _____		
Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: _____		
Vetëm për përdorim zyrtar		
Data e marrjes: ____/____/2024	Numri rendor i kërkesës: _____	Komente: _____
Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".		
<ul style="list-style-type: none">♦ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në uejediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al, portalit <i>qytetsheterin.al</i> apo, kur është rast, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik.♦ Drejtimi i kërkesës tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Ju mund të dërgoni një kërkesë edhe nëpërmjet portalit <i>qytetsheterin.al</i>♦ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.		
<small>¹ Në rastet kur informacioni i kërkuar përmban të dhëna personale, kërkohet dokumenti i identifikimit të kërkuarit.</small>		